



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.60, datë 06.03.2023

PËR

“PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57, pika 2 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 166, pika 2, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, kërkesën Nr.353 prot., datë 28.02.2023, të paraqitur nga prokurori Ols Dado, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit, miratuar me Vendimin e KLP-së Nr.8, datë 20.01.2020, të zotit Ols Dado, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kthimin e zotit Ols Dado në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Ols Dado, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 06.03.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi


ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti


**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**



**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**



**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**



**ANËTAR**  
**Arta Mandro**



**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**



**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

